


Sistemi arsimor dhe shkollor Zvicëran



Rrugët e arsimit

Shkalla e tretë

| | | | | |
|--|--|---|---|---|
| <p>Provimi i profesionit (Berufsprüfung BP)</p> <p>Me provimin e profesionit arrihet deri te çertifikata shtetërore. Njerëzit me çertifikat shtetërore për profesion janë aktiv në lemitë, në të cilat kërkohet njohuri profesionale dhe kualitete udhëheqëse. Kërkesa është në realitet një shkollim bazë i profesionit dhe një përvojë pune disa vjeçare në profesionin përkatës.</p> | <p>Provimi i lartë me diplomë shtetërore (Höhere Fachprüfungen HFP)</p> <p>Me provimet të larta profesionale emërohen njerëzit me diplomë shtetërore dhe janë të kualifikuar për punët me përgjegjësi shumë të mëdha. Për autorizim të provimit lypët në të vërtetë një provim bazë profesional, shpesh një provim i profesionit dhe përvojë pune disa vjetëve në profesionin përkatës.</p> | <p>Shkollat e larta profesionale (Höhere Fachschule)</p> <p>Shkuarja në shkollën e lartë profesionale kërkon një shkollim bazë të profesionit. Në krahasim me shkollën e lartë profesionale superiore (Fachhochschule), ato ofrojnë mësim të shkurtër, më shumë të bazuar në mësim praktik, të cilat mund të absolvojnë gjat kryesë se detyrës së profesionit që i perket. Shkollat të larta profesionale ofrojnë njohuri teorike dhe praktike për njerëzit të specializimë.</p> | <p>FH, Uni dhe ETH ofrojnë përveq studimit në drejtime të ndryshme, edhe studim pasdiplomik dhe kurse në (MAS, DAS, CAS).</p> | |
| | | | <p>Shkolla e lartë profesionale superiore (Fachhochschulen FH)</p> <p>Në shkollën e lartë profesionale superiore ju mundësohet një shkollim në drejtimin e zgjedhur ose një shkollim i mëtejshëm të drejtimin të zgjedhur me orientim praktik dhe teorik. Kjo shkollë ju dedikohet para së gjithash atyre me maturitetin profesional që synojnë për të arritur në një funksion të lartë.</p> | <p>Universitetët dhe ETH</p> <p>Drejtimet universitare dhe ETH janë kryesisht të drejtuara për hulumtime. Këtu mund të studijon kryesisht ata me maturitet gjimnazial. Gjithashtu mundësia për të studiuar në Universitet është edhe për ata me maturitet të profesionit dhe me provim pranues, si dhe për ata me diplomë të shkollës së lartë superiore (FH).</p> |

Shkalla sekondare II

| | | | | |
|---|--|---|--|---|
| <p>Arsimimi bazë i profesionit (EBA)</p> <p>Arsimi bazë i profesionit me atest shtetëror për profesion zgjat 2 vite. Në këtë drejtim prioritet ka mësimi praktikë i profesionit të zgjedhur.</p> | <p>Arsimimi bazë i profesionit EFZ</p> <p>Arsimimi bazë i profesionit me qertifikatë shtetërore të aftësive të profesionit zgjatë, sipas profesionit, 3 ose 4 vite. Gjat këtyre viteve mësohet teoria dhe praktika e profesionit të zgjedhur, si dhe aftësia për profesion.</p> | <p>Maturiteti profesional</p> <p>Maturiteti profesional mundësohet gjatë ose pas arsimimit bazë të profesionit (EFZ). Ai mundëson studimin në shkollë të lartë profesionale përkatëse. Pas dhënjes së provimit përkatës, mbetet hapur edhe mundësia e studimit në ndonjë Universitet përkatës.</p> | <p>Maturiteti i shkollës së mesme profesionale</p> <p>Maturiteti i shkollës së mesme profesionale mundësohet pas shkollës së mesme profesionale, gjatë një viti ku ofrohet praktika dhe shkollimi në të njëjtën kohë. Kjo mundëson hyrjen në shkollë të larta profesionale superiore të drejtimeve të ndryshme.</p> | <p>Maturiteti gjimnazial (GM)</p> <p>Maturiteti gjimnazial mundëson studimet në ndonjërin nga Universitetet ETH. Pas një viti provojë pune, mundësia për të vazhduar në ndonjë shkollë të lartë profesionale superiore, është e hapur.</p> |
| <p>Arsimimi bazë i profesionit (EBA dhe EFZ) përbëhet nga praktika, teoria dhe kurse të ndryshme në profesionin e zgjedhur, të cilat mund të kryhen në Uzina dhe shkolla përkatëse.</p> | | | | |